



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN
PRISHTINA” UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë,
Republika e Kosovës Tel: +381 38 244 183 ·
E-mail: rektorati@uni-pr.edu · www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësi dhe Veterinari

Departamenti: - Bioteknologji në Zootekni

Programi i studimit: Shkencat e Aplikuara në Zootekni

NJOFTIM PËR DISKUTIM PUBLIK

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Përmbledhja e shkurtër e temës master me titull:

“Ndikimi i rrjedhjeve të ujit nga fermat e troftës ylber (*Oncorhynchus mykiss*) në parametrat fiziko-kimike”

i punuar nga kandidatja Arbërtina Xharrahi, ndodhet në diskutim publik 7 ditë duke filluar nga data 19.06.2024 deri me datë 25.06.2024.

Gjatë të njëjtës periudhë, në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nr 06-67 i datës 07. 05 2024 dorëzuar nga komisioni:

1. Prof. dr. Skender Muji - Kryetar
2. Prof. Dr. Agim Rexhepi - Mentor - anëtar,
3. Prof. dr. Muhamet Kamberi - Anëtar,

Versionin e plotë të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkontë tek udhëheqësi shkencor i temës Prof. dr. Agim Rexhepi, përmes e-mail adresës agim.rexhepi@uni-pr.edu

Komentet dhe sugjerimet janë të mirëpritura.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI- BIOTEKNOLOGJI NË ZOOTEKNI



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema: Ndikimi i rrjedhjeve të ujit nga fermat e troftës ylber (*Oncorhynchus mykiss*) në parametrat fiziko-kimike

Mentor
Prof. Dr. Agim Rexhepi

Kandidatja:
Bsc. Arbërtina Xharrahi

Prishtinë, Qershor 2024

Përmbledhje e punimit master

Titulli i temës: **“Ndikimi i rrjedhjeve të ujit nga fermat e troftës ylber (Oncorhynchus mykiss) në parametrat fiziko-kimike”**.

Kandidatja: Bsc Arbërtina Xharrahi

Mentori: Prof. Dr. Agim Rexhepi

Ndikimi në ujërat nga rrjedhjet e fermave të peshkut duhet të vlerësohet, si dhe të ndikohet në përmirësimin e menaxhimit të fermave të peshkut si dhe cilësinë e ujit. Për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, kultivimi i peshkut duhet të fokusohet në zvogëlimin e ndotjes të burimeve ujore dhe menaxhimin e duhur të ushqimit dhe mbetjeve tjera nga fermat e peshkut, si dhe trajtimin e ujit.

Industria me rritje më të shpejtë e prodhimit ushqimor që lidhet me kafshët është sektori akuakulturës. Pasi numri i njerëzve po rritet dita ditës edhe kërkesa e tyre për ushqim po rritet, por prodhimi i ushqimit nuk po e plotëson sasinë e kërkuar. Duke qenë se sasia e siguruar e peshkut nga peshkimi është e kufizuar, industria e akuakulturës duhet të përballojë deri në rritjen e rendimentit të produkteve ujor për të plotësuar sasinë dhe llojet e dëshirueshme të ushqimit për njeriun.

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësohen parametrat fiziko-kimike të ujit nga rrjedhjet prej fermave të troftës së ylberit, i shfrytëzuar nga burime të ndryshme të ujit për kultivimin e peshkut (lumi, përroa, sistemi i ujitjes dhe pusi). Metodologjia e realizimit të këtij studimi ka qenë kuantitative. Të gjitha të dhënat e grumbulluara gjatë punës praktike në ferma janë analizuar dhe klasifikuar me kujdes. Parametrat fiziko-kimik si: temperatura e ujit, pH, oksigjeni i tretur, saturimi dhe TDS (materiet totale të suspenduara) janë matur direkt në ujin e fermës me pajisje adekuate, kurse parametrat tjerë janë analizuar në laborator. Në këtë studim janë përfshirë 24 mostra, të cilat janë marrë në katër ferma të peshkut me burime të ndryshme të ujit si: burimi i ujit nga lumi, përroi, sistemi i ujitjes dhe pusi. Mostrat janë marrë një herë në muaj nga dy mostra në hyrje dhe dalje të fermës, duke i përsëritur për tre muaj.

Rezultatet e fermës së parë, dytë dhe katërt janë brenda kufijve normal për mirëqenien e troftës, ndërsa në fermën e tretë kemi vlera më të luhatshme se ato normale. Kështu, vlerat për faktorët fiziko-kimik që sigurojnë rritjen dhe mirëqenien e troftës ylberi, duhet të jenë brenda kufijve të mëposhtëm: Temperatura (T°C) 16-20°C, turbullira (TUR) 1.5-1.8 NTU, pH 6.0-8.5 njësi, oksigjeni i tretur ≥ 9.0 mg/l, Përçueshmëria elektrike (PE) 200-400 μ S/cm, amoniaku (NH₃) < 0.07 mg/l, shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO) < 15.0 mg/l, shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅) < 30.0 mg/l, nitratet (NO₂) < 0.05 mg/l, nitratet (NO₃) < 15.05 mg/l, fosfatet (PO₄) 0.3 mg/l, joni sulfat (SO₄) < 75mg/l.

Përfundimi i përgjithshëm i këtij hulumtimi është që në bazë të studimit që është realizuar dhe nga rezultatet që kemi mbledhur vërejmë qartë se ndikimi i rrjedhjeve të ujit nga fermat e Troftës Ylber (*Oncorhynchus Mykiss*) në parametrat fiziko-kimike ka rezultuar ndryshe varësisht nga burimi i rrjedhjes së ujit.

Fjelët çelës: trofta ylberi, rrjedhja e ujit, cilësia e ujit, treguesit fiziko-kimik,